



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, specialist i marrëdhënieve me jashtë.

Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ, specialist i marrëdhënieve me jashtë, është përgjegjës për mbarëvajtjen e komunikimit me strukturat brenda dhe jashtë UE-së në lidhje me koordinimin dhe bashkërendimin e punës brenda UE-së dhe jashtë saj për zbatimin e marrëveshjeve ndër-institucionale; person kontakti për komunikimet me IAL brenda e jashtë vendit, kontribuon për përkthimin e materialeve dhe dokumentave të tjera sipas nevojave institucionale duke kryer me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat që i ngarkohen. Raporton periodikisht për veprimtarinë e tij.

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta.

Kriteret e përgjithshme:

- Diplomimi: Kandidati duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë në fushën e shkencave politike/marrëdhënieve ndërkombëtare. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
- Të ketë përvojë të mëparshme pune;
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- Eksperienca e punës: Përvojë pune në sektorin e marrëdhënieve me jashtë;
- Të ketë njohuri shumë të mira të një ose disa gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht të vertëtuara me dokumentacion.
- Aftësi të mira komunikuese e të punës në grup;
- Njohës i mirë i përdorimit të programeve kompjuterike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Çdo kandidat duhet të deklarojë se nuk ka konflikt interesi në përputhje me ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**30.12.2024 – 15.01.2025**):

- Letër motivimi për pozicionin e punës, specialist i marrëdhënieve me jashtë në Drejtorinë e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria e Arsimit dhe Shkencës)
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria e Arsimit dhe Shkencës)
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**30.12.2024 – 15.01.2025**):

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyra”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist i marrëdhënieve me jashtë.*
Elbasan



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (17.01.2025 – 31.01.2025). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.